



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më 06.05.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

ME
OBJEKT

“RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT FUSHË KRUIJË (FAZA I)”

I mbajtur sot me date **06.05.2026**, ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit i ngritur me urdherin e prokurimit **nr.144 datë, 06.05.2026** ,me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur “, me te dhenat e procedures si vijon:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikualifikim urban i qendrës së qytetit Fushë Krujë (Faza I)”

LLOJI I PROCEDURES :PROCEDURE E HAPUR

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pune Ndertimi / (45000000-7)

Fondi limit/Vlera totale e pritshme e kontratave te lidhura gjate vlefshmerise se Marreveshjes Kuader: 105’801’582 (njqind e pese milion e teteqind e nje mije e peseqind e tetedhjet e dy) lekë pa t.v.sh, vënë në dispozicion nga të Ardhurat e Bashkisë Krujë.

- *Vlera e likudimit per **vitin ushtrimor 2026** eshte 5’186’058 (pesembedhjet e milion e treqind e tetedhjet e pese mije e shtateqind e njezet) leke pa t.v.sh dhe 18’462’864(tetembedhjet e milion e katerqind e gjashtedhjet e dy mije e teteqind e gjashtedhjet e kater) leke me t.v.sh, **per vitin ushtrimor 2027** vlera e likudimit do te jete ne shumen prej 57’374’877(pesedhjet e shtate milion e treqind e shtatedhjet e kater mije e teteqind e shatedhjet e shtate) leke pa t.v.sh dhe 68’849’852(gjashtedhjet e tete milion e teteqind e dyzet e nente mije e teteqind e pesedhjet e dy) leke me t.v.sh, **per vitin ushtrimor 2028** vlera e likuidimit do te jete ne shumen 33’040’986(tridhjet e tre milion e dyzet e mije e nenteqind e tetedhjet e gjashte) leke pa t.v.sh dhe 39’649’183(tridhjet e nente milion e gjashteqind e dyzet e nente mije e njeqind e tetedhjet e tre) leke me t.v.sh .*

BURIMI I FINACIMIT: Te ardhurat e Bashkisë Krujë, sipas programeve buxhetore te miratuara me **VKB nr.68 date 23.12.2025** ‘‘Per miratimin e buxhetit te vitit 2026’’ , ndryshuar me VKB nr.10 date 22.04.2026 ‘‘Per miratimin e buxhetit shtese te vitit 2026’’.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 ‘‘Për prokurimin publik’’, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’, autoriteti/enti, **Bashkia Kruje** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2026 per secilin operator).*

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2026 per secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

b)Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura/MIE. Shoqëria ofertuese duhet të paraqesi licencën e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si më poshtë vijon:

b)Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura/MIE.

Shoqëria ofertuese duhet të paraqesi licencën e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si më poshtë vijon:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

-NP-1/A→Punime gërmimi në tokë.

-NP-4/C→Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

-NP-11/A→Punime për nënstacione, gabinetat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

-NS-6/A→Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese.

-NS-18/A→Punime topogjeodezike.

Shenim-Licensa duhet te jete leshuar ne perputhje me kerkesat e VKM nr.42, date 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” te ndryshuar me VKM nr nr. 92 date 19.02.2014.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktues, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008 si dhe VKM 729, dt.12.11.2014 ndryshuar me VKM 943.DT 28.12.2016). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar duke u bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të objektit të prokurimit, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë	Punime gjurmimi në tokë. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve të gjurmimit, sipas	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

		zërit nr.1, 2, 3, 4 (Lot I) dhe nr. 1, 2, 3, (Lot III) të preventivit.		
NP -4	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve rrugore, sipas zërit nr.5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 37, 38, 39, 40, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 76, 77, 79, 80, 81, 84, 85, 86, 87, 88 (Lot I) dhe nr.4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 22, 23, 24, 25, 31, 32, 33, 34, 43, 44, 45, 46, 48, 49, 52, 53, 54 (Lot III), të preventivit.	C	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NS-6	Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese.	Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve të sinjalistikës rrugore, sipas zërit nr.27, 28, 29, 30, 31, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 78, 82, 83, 89 (Lot I) dhe nr.19, 20, 35, 37, 50, 51 (Lot III), të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NS-11	Punime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.	Punime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve elektrike, sipas zërit nr.31, 32, 33, 34, 35, 36, 41, 42, 43, 44, 58, 60, 61, 62, 63, 75 (Lot I), dhe	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

		nr.21, 26, 27, 28, 29, 30, 38, 40, 41, 42, 47 (Lot III) të preventivit.		
NS -18	Punime Gjeodezike	Punime topogjeodezike. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve topogjeodezike, sipas zërit nr.1, 2, 3, 9, 10, 12, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 37, 45, 46, 47, 48, 64, 66, 67, 68, 69, 88 (Loti I) dhe nr.1, 2, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 22, 29, 31, 32, 44, 45 (Lot III) të punimeve rrugore të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.3-a)-Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2023,2024,2025), të certifikuara nga autoritetet përkatëse kompetente (Drejtorite Rajonale te Tatimeve) , që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse ne treguesit e bilanceve per dy vite te njepasneshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3.1.b)-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaratimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2023,2024,2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku

vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vleras e fondit limit te kontrates qe prokurohet përkatësisht: **105'801'582 (njqind e pese milion e teteqind e nje mije e peseqind e tetedhjetë e dy)** lekë pa t.v.sh

Shenim-Pika 2.3.1-b) plotësohet duke paraqitur vërtetimin përkatës të Administratës Tatimor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.(b)**, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rëndësishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e nën kufirin e ulët monetar dhe iu jep mundësinë ndër të tjera dhe operatorëve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

paraqesin të dhënat provuese si më poshtë në ekzekutimin e kontratave të:

a) punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 % e vlerës** së përlllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht në shumën **52'900'791 (pesedhjetë e dy milion e nentëqind mije e shtatëqind e nentëdhjetë e një) leke pa tvsh** dhe që është realizuar gjatë 5 (pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5 (pese) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se vlera e **dyfishit të fondit limit të kontratës** që prokurohet dhe konkretisht, **211'603'164 (dyqind e njembedhjete milion e gjashtëqind e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjete e kater) lekë pa t.v.sh .**

Shenim- Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme

c) Pika “2.3.1/a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika “2.3.1/b “ duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

d) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentat e mëposhtme provuese:

i-Per punimet e kryera ne sektorin publik duhet te paraqitet dokumentacioni provues te meposhtem si vijon i vlefshem:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 09, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar të objektit ;
- Fatura tatimore përfundimtare të shitjes të deklaruara në organet tatimore .
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

ii-Ndersa ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin provues te meposhtem te vlefshem :

- Kontraten e sipërmarrjes
- Situacionin përfundimtar të objektit
- Akt kolaudimit të objektit .
- Faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore .

(Elementet provues të mesipërme janë kërkuar në referim të legjislacionit përkatës në fuqi për disiplinimin e kontrollin e punimeve të ndërtimit e me konkretisht në referencat e dispozitave të Ligjit Nr.8402, Datë 10.9.1998 „Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit“ i ndryshuar ,dhe VKM nr 408 date Nr. 408, datë 13.5.2015““ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“ i ndryshuar.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e

procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në *Nenin 39 pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021* “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: ***”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*** Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave perkatëse të DST, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e perqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet të ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Marzhi i mesiperm eshte konsideruar i tille qe pare ne aspektin e ofertimit iu jep mundesi dhe akses pjesemarrje ne konkurim edhe subjekteve ofertues te cilet jane biznese te vegjel ose te mesem duke zgjeruar hapesiren e ofertimit.

Kapaciteti teknik si pjese integrale e kriterëve të vecanta është hartuar nga DPZHT dhe janë percjelle ne NJ.P.P me shkresen nr.3418 Prot date 06.05.2026 , si vijon:

2.3.2-a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, staf inxhinierik si më poshtë për të cilin duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme (me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.

-Inxhinier Ndertimi/ ing.Rruga Ura/ ing.Transporti → **1 inxhinier.**

-Inxhinier Gjedodet/ing.Topograf → **1 inxhinier.**

-Inxhinier Elektrik → **1 inxhinier.**

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një afat kohor që i përket realizimit të punimeve në një afat prej prej 06(gjashtë gjashtë) muaj , i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Kapaciteti për fuqi punëtore inxhinierike për stafin e kerkuar inxhinierik bazohet në K.Punës, dhe në V.K.M. nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar dhe lidhet ngushtësisht me nevojën për realizimin në kohë të objektit të kontratës duke iu referuar zbatimit të punimeve, si dhe në përputhje me zërat dhe volumet e punimeve të preventivit sipas projektit të zbatimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi/t i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin

teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3-6-Personeli mbeshtetes i kualifikuar dhe teknik

2.3.4- a)-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **5 (pese) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda specifikuara sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator (Rruli vibrues/ rrul asfalti) →**1 manovrator**
- Manovrator (Autobitumatriçe/ autovinc) →**1 manovrator.**
- Manovrator Grejderi →**1 manovrator.**
- Manovrator Asfalto-shtruese→**1 manovrator**

Për çdo profil punonjesi teknik si më sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës) si dhe dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente përkatëse sipas modaliteteve të **urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019**

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin e drejtuesve të mjeteve motorike dhe atyre **te makinerive te rënda**, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për shoferet/manovratorët/drejtuesit të mjetit në objektin konkret është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe qarkullimit të mjeteve dhe certifikimit të personelit të drejtuesve të mjeteve të qarkullimit rrugor e makinerive të rënda. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve prandaj disponimi i tyre është faktor i rëndësishëm për përmbushjen me sukses të kontratës së sipërmarrjes së punëve të ndërtimit sipas natyrës së projektit të zbatimit.

Numri i profilit të personelit të mesipër , është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve, duke patur në konsideratë zërat e punimeve të preventivit të zbatimit.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë.

2.3.4-b)-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë shofere/drejtues mjeti gjithsej **05(pese) punonjës te drejtimit te automjeteve** të profileve të mëposhtme:

- Shoferë kamioni→**2 shoferë**,
- Shoferë kamioncine→**1 shofer**
- Shoferë autoboti→**1 shofer**
- Shoferë kamioni me vinç→**1 shofer**

Per cdo profil te shofereve te mesiperm nga ana e operatorit ekonomik pjesemarrës duhet te paraqitet si prova apo deshmi te disponimit te tyre dokumentacioni i meposhtem:

- Kontrata individuale punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates).
- Leja e Drejtimit per kategorine perkatese sipas kerkesave te rregulloreve ne fuqi te miratuara nga autoritetet kompetent publike (e vlefshme).
- Dëshmite e aftesise profesionale ose Certificate te Aftesise Profesionale(CAP)(të vlefshme),lëshuar nga institucionet perkatese/autoritetet kompetente sipas rregullave te qarkullimit rrugor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise sipas kategorise respektive te mjetit .

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore te disponimit te shofereve te mjeteve motorike sipas profilit te tyre eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, si dhe ne raport te nderlidhur me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlogaritur nenje kohe te percaktuar prej 36(tridhjetë e gjashtë) dite , afat i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.Gjithashtu per profilin e manovratoreve/shofereve/drejtuesve te mjeteit eshte marre ne konsiderate direkte natyra e zerit te punimeve perkatese te cilet mund te zbatohen vetem nepermjet proceseve te mjeteve e makinerive te vecanta.

2.3.3.-Personeli dhe fuqia punetore:

a)-Kandidati/ofertuesi/ Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën **31 (tridhjetë e nje) punonjesve** duke përfshire personelin teknik , drejtuesit teknik si dhe mbeshtetes , për periudhen e 3 (tre) muajve të fundit te deklarimit tatimor ,duke nisur nga data e hapjes së ofertave/shprehjes se interesit. te provuar , si më poshtë:

- Vertetim te leshuar administrate tatimore kompetente sipas legjislacionit fiskal ne fuqi ku te specifikohet nr. total i punonjesve per te cilet derdhet kontribut sigurimi shoqeror/shendetesor sipas legjislacionit ne fuqi .

Ose

- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 025) sipas formatit elektronik ne perputhje me VKM nr 922 date 29.12.2014''**Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike**''.

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **3(tre) muajt e fundit te vlefshem te deklarin sipas legjislacionit ne fuqi** tregon besueshmëri/garanci për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale te lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **3(tre) muajt e fundit te vlefshem te deklarin sipas legjislacionit ne fuqi** tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Vendosja e kriterit për njëpunësim te paktën **31 (tridhjetë e nje) punonjesve**, duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen

punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne **VKM nr.216 DT 13..04.2023'' Sistemi i Integruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim''**.

2.3.5-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

I.MAKINERI	Njësia	Sasia	Pronësia
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	copë	2	Pronësi ose me qera
Kamionçinë nën 3.5 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç.	copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator (zinxhirë/ goma).	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues i tonazhit të madh.	copë	1	Pronësi ose me qera
Grejder.	copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe.	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
Makineri për skarifikim asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autovinç 2.5÷5 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
II.PAJISJE			
Betonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni.	copë	1	Pronësi ose me qera
Matrapik.	copë	1	Pronësi ose me qera
Jelekë fosforeshentë/uniforma pune.	copë	41	Pronësi ose me qera
Kallëp dërrase.(armaturë).	m2	200	Pronësi ose me qera
Prerëse (sharrë) asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
Tabela rrugore (për punime në rrugë).	copë	9	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	41	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

1. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi duhet të paraqitet a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit në pronesi leja e qarkullimit (e vlefshme) - b) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracionin e detyrueshëm të mjetit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (i vlefshëm); d) Certifikatë transporti mallrash sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (e vlefshme), ndërsa për mjete të marra me qira/perdorim krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet/n edhe kontrata/t përkatëse të qerasë/marrjes në përdorim e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.
2. Për mjetet/pajisjet/makineritë të cilat nuk i nënshtrohen detyrimit ligjor për tu regjistruar në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton titullin e pronësive të vlefshme si kontrata e shitblerjes /akti çdoganimit/fatura tatimore e blerjes perkates/e, ndërsa për mjete të marra me qera/perdorim krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerases/marrja në përdorim e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
3. Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
5. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 08.pika C (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
6. Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi).

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e

objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar zerave respektiv te punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në analiza të mbeshetur ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në fuqi për disiplinimin e punimeve të ndertimit. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, specialisti perkates është mbeshetur teresisht në analizave teknike të cmimeve dhe kostot e fuqisë e punetorisë dhe makinerive të hartuara nga ana e autoreve të projektit të zbatimit, në referim të cdo zeri punimesh i pasqyruar në preventivin e punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës *bazuar në VKM nr.216 DT 13.04.2023* “Sistemi i Integruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim”.

- **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.3.6-Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

- Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te analizave teknike te hartuara nga ana e autoreve te projektit te zbatimit
- Projekti zbatimit, Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licensuar dhe jane pjese e DST.
- Ne çdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent.

Shenim:Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr.216 DT 13.04.2023” Sistemi i Itegruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim”.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2,55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT